



Republika e Maqedonisë

**KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Nr. 07-493/5 27 shkurt 2014**

Në bazë të nenit 31 paragrafi 2 alineja 2 të Kodit zgjedhor („Gaz.zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11 – Tekst i pastruar, 142/12, 14/14 dhe 32/14 – Tekst i pastruar) Komisioni Shtetëror i zgjedhjeve, në seancën e mbajtur më 21 shkurt 2014, miratoi

### **UDHËZIM**

**për implementimin e nenit 111 të Kodit zgjedhor**

**-për persona të sëmurë dhe të paaftë -**

**-tekst i pastruar -**

#### **neni 111 të Kodit zgjedhor**

- (1) Zgjedhësi i cili nuk është në gjendje të votojë në vendvotim (person i sëmurë ose i paaftë sipas udhëzimit të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve), ndërsa dëshiron të votojë për këtë më së voni shtatë ditë para ditës së zgjedhjeve duhet ta njoftojë Komisionin komunal të zgjedhjeve, përkatësisht Komisionin zgjedhor të Qytetit të Shkupit. Njoftimi i dorëzuar nga paragrafi (1) të këtij neni i përket rrethit të parë dhe të dytë të votimit.
- (2) Njoftimi nga paragrafi (1) të këtij neni mund të dorëzohet edhe me anë të personit të autorizuar.
- (3) Këshilli zgjedhor, personit nga paragrafi (1) të këtij neni, një ditë para ditës së zgjedhjeve do ti mundësojë që të votojë në shtëpinë e tij, ashtu që në mënyrë të sigurohet fshehtësia e votimit.
- (4) Komisioni komunal i zgjedhjeve, për gjithë personat e sëmurë dhe të paaftë kryen kontroll elektronik në Listën zgjedhore. Komisioni komunal i zgjedhjeve, pas kontrollit të kryer, përpilon listë për gjithë personat e paraqitur në mënyrë të rregullt të cilët gjenden në Listën zgjedhore. Një ekzemplar të listës së përpiluar e dërgon në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve.
- (5) Këshilli zgjedhor, votimin nga paragrafi (3) të këtij neni, e shënon në procesverbal.
- (6) Ky anëtar i Këshilli zgjedhor, për ditën dhe kohën e votimit nga paragrafi (3) të këtij neni e njofton Komisionin komunal të zgjedhjeve, përkatësisht Komisionin zgjedhor të Qytetit të Shkupit, me shkresë i njofton përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listës.

1. Me fjalën person i sëmurë ose i paaftë nënkuptojmë, person i cili nuk është në gjendje ti kryejë nevojat elementare jetësore (nuk është në gjendje të lëvizë nëpër banesë as me shfrytëzimin e mjeteve ndihmëse përkatëse, të mirëmbajë higjienë personale, të vishet, të ushqehet, as të kryejë veprime tjera të mjaftueshme për nevojat elementare jetësore), përkatësisht është i palëvizshëm, krejtësisht i verbër, i sëmurë prej distrofisë ose sëmundjeve të ngajshme muskulare, nga paraliza cebrale ose fëmijnore apo nga paraplegjia).

2. Njoftimi i personit nga paragrafi(6) të nenint 111 të Kodit zgjedhor, se ka dëshirë të votojë i dorëzohet Komisionit komunal të zgjedhjeve ku personi e ka adresën e banimit të përhershëm Përveç njoftimit në Komisionit komunal të zgjedhjeve, duhet të dorëzohet edhe prova medicinale ose aktvendimin për shërbimin e përkujdesjes prej personit të tretë për sëmundjet e cekura në alinenë<sup>1</sup> të këtij Udhëzimi). Votimin e kryen Këshilli zgjedhor ku personi është i regjistruar në ekstraktet e Listës zgjedhore për vendvotimin përkat

3.Zgjedhësi person i sëmurë ose i paaftë mundet të votojë edhe në shtëpinë e personit të afërt në adresë ndryshe nga ajo në dokumentin e identifikimit personal, me kusht që ajo adresë të jetë në territorin e komunës ku voton zgjedhësi. Në këtë rast në njoftimin e dorëzuar në KKZ duhet të shënohet edhe adresa ku gjendet personi.

4. Komisionit komunal të zgjedhjeve, do të përpilojë listë për gjithë personat e sëmurë ose i paaftë të paraqitur në mënyrë të rregulltë dhe një eksemplar të njëjtës e dorëzon në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve.

5. Këshilli zgjedhor, para se të fillojë me votimin e personave të sëmurë ose të paaftë,nga blloku amë(koçani) këput aq fletvotime sa persona të sëmurë ose të paaftë ka të evidentuar për vendvotimin përkatës, ndërsa bllokun amë(koçanin) nuk guxon gjatë votimit ta mbajë me vehte .

6. Këshilli zgjedhor, gjatë zbatimit të votimit e personave të sëmurë ose të paaftë e përdorë kutinë e votimit të cilën ia ka dorëzuar Komisionit komunal të zgjedhjeve për këtë votim dhe e njëjta do të përdoret në ditën e zgjedhjeve.

Këshilli zgjedhor, me vehte mban edhe ekstraktin e Listës zgjedhore ku nënshkruhet personi i sëmurë ose i paaftë.

7. Para se të fillojë votimi, kapaku i kutisë së votimit duhet të jetë i mbyllur nga të dy anët me shirit sigurues plastik të numeruar.

8. Personi i sëmurë ose i paaftë, fletëvotimin pas mbarimit të votimit e palos, e vendosë në zarf të posaçëm e mbyll dhe e lëshon në kuti të votimit.

9. Pas mbarimit të votimit, zarfet me fletëvotime mbeten në kuti të votimit, ndërsa vrima e kapakut mbyllet me shirit sigurues plastik të numeruar..

Ekstrakti i Listës zgjedhore, bashkë me bllokun amë(koçanin) e fletëvotimeve vihen në një thes klastiku të dejdkushëm dhe mbyllet me shirit sigurues plastik të numeruar.

10. Nëse pas mbarimit të votimit të personave të sëmurë ose të paaftë,mbeten fletëvotime të pardorura, të njëjtat nuk guxojnë të përdoren për ditën e zgjedhjeve, këtyre iu këputet këndi i poshtëm dhe ruhen në një zarf të posaçëm dhe në ditën e zgjedhjeve gjatë sumimit të rezultateve, evidentohen bashkë me fletëvotimet tjera të papërdorura..

11. Kutia e votimit në ditën e zgjedhjeve para fillimit të votimit hapet, nxirren zarfet dhe hapen një nga një, fletëvotime pa u parë se për cilin është votuar vendosen në kuti të zbrazur të votimit. Kutia e votimit në të dy anët e kapakut mbyllet me shirit sigurues plastik të numeruar.

12. Këshilli zgjedhor, në ditën e zgjedhjeve nuk guxon t,ju lejojë atyre personave të sëmurë ose të paaftëtë cilët një ditë më parë kanë refuzuar të votojnë ose nuk janë hasur në shtëpitë e tyre

13.Këshilli zgjedhor, i cili zbaton votimin e personave të sëmurë ose të paaftë është i detyruar mbajë evidencë për ata që kanë refuzuar të votojnë ose nuk janë hasur në shtëpitë e tyre. Këshilli zgjedhor, këtë evidencë e bashkangjitë në ekstraktin e listës zgjedhore në të cilën votohet.

14. Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi pushon vlefshmëria e:Udhëzimit për

implementimin e nenit 111 të Kodit zgjedhor nr. 11-684/1 14.02.2013

15. Ky Udhëzim me ditën e miratimit hyn në fuqi .

16. Ky udhëzim shpallet në veb faqen Komisioni Shtetëror i zgjedhjeve

**VENI RE :** Komisionet komunale të zgjedhjeve, gjatë pranimit të kërkesës për votimin e personave të sëmurë ose të paaftë të kenë kujdes në kontrollimin e dokumentacionit se janë parashtruar shkaqet nga alineja 1 dhe 2 të këtij Udhëzimi,

**KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**KRYETAR**

**Nikolla Rillkoski**

( vula dhe nënshkrimi personal)

